



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

PROJEKT-VENDIM

Nr. Datë .2026

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME
NDIHMË EKONOMIKE NGA PËRDORIMI I FONDIT SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR TË
BLLOK - NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6% PËR VITIN 2026**

Duke u mbështetur në Ligjin nr 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", në vendimin nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", i ndryshuar, Vendimi nr. 855, datë 26.12.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%" të Ministrisë së Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve me propozim të Kryetarit të Bashkisë i kërkon Këshillit Bashkiak të miratojë në mbledhjen e datës _____:

PROPOZOI:

Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike.

Përfitues të fondit të kushtëzuar 6% do të jenë:

- 1- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike në sistem dhe që nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
- 2- Familjet para se të përzgjidhen për t'u trajtuar me këtë fond, duhet të jenë të verifikuara paraprakisht nga administratori Shoqëror.
- 3- Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
- 4- Familje me kryefamiljarë të ve ose të divorcuar me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
- 5- Familjet që i përkasin komunitetit rom dhe janë në varfëri ekstreme.
- 6- Familjet me një anëtar që nuk kanë të ardhura ose i kanë të pamjaftueshme.
- 7- Familje në varfëri ekstreme.
- 8- Familjet të cilat nuk refuzojnë punësimin.
- 9- Ky projekt-vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak.
- 9- Për zbatimin e tij ngarkohet administrata e Bashkisë.

Konceptuar nga: A. Dajani
Miratuar nga: Drejtori D. S.H.S.Zh.E.F.E. Dake
Kryetar: Drejtori D.Ç.J.F.P.O.Liço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Nr. 567 prot.

Datë 22.01 .2026

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIM
Nr. _____ Datë _____ / _____ /2026

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME
NDIHMË EKONOMIKE NGA PËRDORIMI I FONDIT SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR TË
BLLOK - NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% PËR VITIN 2026**

Duke u mbështetur në Ligjin nr 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar, Vendimi nr. 855, datë 26.12.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” të Ministrisë së Mirëqenies Sociale, i kërkohet Këshillit Bashkiak miratimi i kriterëve për përfitimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6%. Kriteret janë në zbatim të gjithë bazës ligjore rregulluese të procedurës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit të kushtëzuar 6%.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konc: Spec A. Dajani
Miratol: Drejtori D. H.S.ZH.E.F E. Dake
Konfirmoi: Drejtori M.C.J.P.P O.Lifo

